



**Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri**

Public Affairs and Media Office
Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe e Medias

DEKLARATË PËR SHTYP

Prezenca e OSBE-së zhvillon seminare për ligjin kundër dhunës në familje

TIRANË, 27 prill 2007 – Gjykatës, prokurorë dhe policë shqiptarë morën pjesë në disa seminare për ndihmesën ndaj viktimave të dhunës në familje, të zhvilluara gjatë dy javëve të fundit. Ato u organizuan nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Këshilli i Evropës dhe Shkolla e Magjistraturës dhe u përqendruan në Ligjin për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare, e cili do të hyjë në fuqi në qershor.

Mbi 120 pjesëmarrës nga Gjirokastra, Vlora dhe Tirana diskutuan risitë kryesore që sjell ligji dhe si të kërkojnë dhe lëshojnë urdhra mbrojtjeje kundër dhunuesve.

Maya Goldstein, Këshilltare e Lartë e Prezencës për Çështjet Gjyqësore, tha se raportet e përgatitura nga OSBE-ja kanë konstatuar se krimet e dhunës në familje nuk hetohen dhe nuk dënohen siç duhet. “Fuqia e re që u jepet gjykatave për të lëshuar urdhra civilë mbrojtjeje u ofron viktimave të dhunës zgjidhje të shpejta dhe të përballeshme dhe jep mesazhin që dhunuesit do të përgjigjen para ligjit”, shtoi ajo.

Prezenca e OSBE-së ndihmoi në hartimin e ligjit kundër dhunës në familje, i pari i këtij lloji në Shqipëri.

Ligji u propozua nga shoqëria civile dhe u miratua nga Kuvendi më 18 dhjetor 2006. Ai i detyron strukturat shtetërore të përgjigjen menjëherë ndaj rasteve të dhunës në familje dhe të mbrojnë viktimat.

Seminaret ishin pjesë e projektit të Prezencës të quajtur “Aksesi i Grave në Sistemin e Drejtësisë”. Në kuadër të këtij projekti, 50 avokatë u trajnuan për ligjin, gjatë muajit mars, në Tiranë dhe Vlorë. Veprimtaritë e ardhshme të Prezencës në këtë fushë do të përfshijnë trajnimin e shoqatave jofitimprurëse mbi ligjin e ri.